

**KËRKESA TË PËRBASHKËTA PËR TË DHËNAT PËR REGJISTRIMIN E
OPERATORËVE EKONOMIKË DHE PERSONAVE TË TJERË**

TITULLI I

Kërkesa për të dhënat

KAPITULLI 1

Shënime hyrëse në tabelën për kërkesat e të dhënave

1. Sistemi qendror i përdorur për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe personave të tjerë përmban elementë të të dhënave të përcaktuara në Titullin I, Kapitulli 3.
2. Elementët e të dhënave që duhet të jepen janë përcaktuar në tabelën e kërkesave të të dhënave. Dispozitat specifike lidhur me secilin element të të dhënave siç janë përshkruar në Titullin II, zbatohen pa paragjykim ndaj statusit të elementeve të të dhënave siç përcaktohet në tabelën e kërkesave të të dhënave.
3. Formatet e kërkesave për të dhënat të përshkruara në këtë Aneks specifikohen në Vendimin 247/2017 e cila është miratuar sipas Nenit 18(a) të Kodit.
4. Simbolet 'A' ose 'B' të listuara në Kapitullin 3, më poshtë nuk kanë asnjë ndikim në faktin se disa të dhëna janë mbledhur vetëm kur rrethanat e kërkojnë atë.
5. Regjistrimi RIOE mund të fshihet vetëm kur kalon afati i ruajtjes prej 10 vjetësh, pas datës së mbarimit.

KAPITULLI 2

LEGJENDA E TABELAVE

Seksioni 1

Krerët e kolonave

Numri i elementit të të dhënave (NE)	Numri i rendit të vendosur të elementit përkatës të të dhënave
Emri i elementit të të dhënave	Emri i elementit përkatës të të dhënave

Seksioni 2

Simbolet nëpër kutiza

Simboli	Përshkrimi i simbolit
A	I detyrueshëm: kur e dhëna kërkohet në R.Sh..
B	Opsional për R.Sh.: e dhënë që mund të mos e kërkohet nga R.Sh

KAPITULLI 3

Tabela e kërkesave për të dhënat

Nr. N.E.	Emri N.E.	N.E. i detyrueshëm / opsional
1	Numri RIOE	A
2	Emri i plotë i personit	A

Nr. N.E.	Emri N.E.	NE. i detyrueshëm/opsional
3	Adresa e shoqërisë/adresa e rezidencës	A
4	Vendndodhja në territorin doganor të R.Sh.-së	A
5	Numri identifikues i NIPT/NUIS/TVSH-së	A
6	Statusi ligjor	B
7	Informacione kontakti	B
8	Numri uniki identifikimit të njëvendi tjetër	B
9	Miratimi për publikimin e rë dhënave personale të renditura në pikat 1, 2 dhe 3	A
10	Emri i shkurtuar	A
11	Data e krijimit	B
12	Lloji i personit	B
13	Aktiviteti ekonomik kryesor	B
14	Data e fillimit të numrit RIOE	A
15	Data e mbarimit të numrit RIOE	A

TITULLI II

Shënime lidhur me kërkesat për të dhënat

Hyrje

Përshkrimet dhe shënimet e përfshira në këtë titull kanë të bëjnë me elementët e të dhënave të referuara në tabelën e kërkesave për të dhënat në Titullin I.

Kërkesat për të dhënat

1. Numri RIOE

Për numrin RIOE referoju nenit 1(18).

2. Emri i plotë i personit

Për personat fizikë:

Emri i personit siç tregohet në dokumentin e udhëtimit të njohur si të vlefshëm për qëllim kalimin në kufirin e jashtëm të R.Sh. ose në regjistrin kombëtar të shtetit ku ai është rezident.

Për operatorët ekonomikë që janë përfshirë në regjistrin e biznesit të R.Sh:

Emri ligjor i operatorit ekonomik të regjistruar në regjistrin (tregtar) të biznesit të R.Sh.

Për operatorët ekonomikë që nuk janë të përfshirë në regjistrin e biznesit të R.Sh.

Emri ligjor i operatorit ekonomik siç tregohet në aktin e krijimit/themelimit të shoqërisë.

3. Adresa e shoqërisë/adresa e rezidencës

Adresa e plotë e vendit ku është vendosur/banon personi, përfshirë identifikuesin e vendit apo territorit.

4. Shoqëria në territorin doganor të R.Sh.

Për të treguar nëse operatori ekonomik është apo jo i vendosur në territorin doganor të R.Sh. Ky element i të dhënave përdoret vetëm për operatorët ekonomikë me adresë në një vend tjetër.

5. Numri identifikues i NIPT/NUIS/TVSH-së

Aty ku përcaktohet nga R.Sh..

6. Statusi ligjor

Siç jepet në aktin e themelimit/krijimit.

7. Informacion kontakti

Emri i personit të kontaktit, adresa dhe secila nga këto: numri i telefonit, faksit dhe adresa e e-mailit.

8. Numri unik identifikues i vendit tjetër

Në rastin kur një person nuk është i vendosur në territorin doganor të R.Sh:

Numri identifikues i caktuar për personin në fjalë nga autoritetet kompetente në një vend tjetër për identifikimin e operatorëve ekonomik për qëllime doganore.

9. Miratimi për publikimin e të dhënave personale të renditura në pikat 1, 2 dhe 3

Tregon nëse është dhënë apo jo miratimi.

10. Emri i shkurtuar

Emri i shkurtuar i personit të regjistruar.

11. Data e krijimit

9. Për personat fizikë:

Data e lindjes

Për personat juridikë dhe shoqatat e personave siç referohet në nenin 6(4) të Kodit: data e krijimit siç figuron në regjistrin tregtar të biznesit të R.Sh. ku ai është krijuar ose në aktin e krijimit kur personi ose shoqata nuk është i regjistruar në regjistrin e biznesit.

10. Lloji i personit

Përdoret kodi përkatës

11. Aktiviteti ekonomik kryesor

Aktiviteti ekonomik kryesor në përputhje me Klasifikimin Statistikor të Aktiviteteve Ekonomike në Bashkësinë Evropiane (NACE), të listuar në regjistrin e biznesit të R.Sh..

12. Data e fillimit të numrit RIOE

Dita e parë e periudhës së vlefshmërisë të regjistrimit RIOE. Kjo do të thotë, dita e parë kur operatori ekonomik mund të përdorë numrin RIOE për shkëmbime me autoritetet doganore. Data e nisjes nuk mund të jetë përpara datës së krijimit.

13. Data e mbarimit të numrit RIOE

Dita e fundit e periudhës së vlefshmërisë së regjistrimit RIOE. Kjo do të thotë, dita e fundit kur operatori ekonomik mund të përdorë numrin RIOE për shkëmbime me autoritetet doganore.
